



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8 Mars 2021

Nr: 121

VENDIM

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR PËRZGJEDHJEN E MONITORUESVE
NGA THIRRJA E TRETË PËR TË PLOTËSUAR NUMRIN E VAKANCAVE NË QARKUN E
LEZHËS DHE SHKODRËS**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit” dhe pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm

VËREN

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit, si dhe në përmbushje të detyrimit administrativ për njoftimin e palëve, ka bërë njoftim publik për rihapjen e aplikimeve për monitorues për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 për të plotësuar numrin e 2 vakancave në qarkun e Lezhës. Ky njoftim publik është realizuar nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të institucionit.

Pas njoftimit publik, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zbatim të udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”, kanë depozituar dokumentacionin 10 (dhjetë) aplikant të interesuar për monitorues për qarkun e Lezhës.

Komisioni i Posaçëm i ngritur për verifikimin e plotësimit të kritereve formale të aplikantëve për monitorues dhe procedurën e intervistimit me kandidatët e kualifikuar shqyrtoi të gjitha aplikimet e depozituara dhe përzgjedhi listën prej 9 (nëntë) kandidatëve për monitorues duke përjashtuar 1 (një) aplikant pasi nuk kishte dorëzuar të gjithë dokumentat e kërkuara të udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”.



Të 9 (nëntë) kandidatët për monitorues plotësojnë kriteret e përcaktuara të udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”.

Për sa më sipër shorti për emërimin e monitoruesve u organizua për qarkun e Lezhës. Gjithashtu për shkak të 1 (një) vakance që u krijua në qarkun e Shkodrës u hodh dhe shorti për këtë qark.

Më datë 08.03.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi shortin për përzgjedhjen e monitoruesve për qarkun Lezhë dhe Shkodër.

Në një kuti transparente u futën 9 (nëntë) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 9 (nëntë) kandidatëve për monitorues pjesëmarrës për qarkun Lezhë, nga të cilët u përzgjodhën 2 (dy) monitorues. Në një kuti tjetër transparente u futën 2 (dy) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 2 (dy) kandidatëve për monitorues pjesëmarrës për plotësimin e 1 vakance në qarkun Shkodër, nga të cilët u përzgjodh 1 (një) monitorues.

PËR KËTO ARSYE

Referuar nenit 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, “Për caktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”

V E N D O S

1. Të miratoj listën e monitoruesve për vakancat në qarkun Lezhë, të cilë do të kryejnë monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
 - 1) Sajmira Selmani
 - 2) Elejd Hafizi
2. Të miratoj listën e monitorueses për vakancën në qarkun Shkodër, e cila do të kryej monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit si më poshtë vijon:
 - 1) Megi Dukeli
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI

